

KURTHET E TRAFIKIMIT TË QENJEVE NJERËZORE – EDHE JU MUND TË BINI VIKTIMË ENDE NUK E BESONI?

Publikimi dhe shpërndarja financuar nga: UNHCR

Autorë: Shoqëria Ključ – Qendra për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore,
Slloveni

Jeni larguar nga shtëpia dhe keni shkuar jashtë vendit për të kërkuar një të ardhme më të mirë për veten dhe familjen, për të gjetur (krijuar) një shtëpi të re dhe siguri. Ju 'ndodh' të takoni dikë që është i gatshëm të ju 'ndihmojë'. Ata ju thanë se do të ju siguronin vizën dhe dokumentin e udhëtimit pa pagesë. Ata njohin dikë që do t'ju çojë përtej kufirit dhe dikë tjetër që do t'ju presë në anën tjetër. Ata ju thanë që të heshtni nëse diçka shkon keq në pikën kufitare ose nëse ju ndalon policia. Sigurisht që do të ju duhet të flini diku. Ku? Nuk e dini se ku.

Thonë se do të punosh tek shokët e tyre dhe do të paguhesh mirë. A është kjo punë në ndonjë lokal?

Ndonjë sallon masazhi? Në apartament apo punishte? Në ndërtimtari? Në fermë? Apo është në rrugë si lypsarë ose ku do të duhet të luani në ndonjë instrument ose do të shitni trupin tuaj? Edhe pse nuk e kuptoni gjuhën sllovene, italiane, angleze, gjermane, kjo nuk krijon problem; do ta mësoni sëshpejti. Ata poashtu mund të ju prezantojnë me



A PO JU SHANTAZHON OSE KËRCNON DIKUSH?

**A I MORRËT BORGJ DIKUJT PARATË QË JU NEVOJITËN
PËR UDHTIM PËRNË EUROPË?**

A E NJIHNI PËRNJEMEND NJERIUN ME TË CILIN PO UDHËTONI?

SI E DINI QË MUND TU BESOHE?

**ATA PERSONA A KANË SHUMË PARA, SHOKË DHE
AUTOMOBIL TË MIRË? PREJ NGA JU VIJNË PARATË? KUSH
JANË SHOKËT?**

**A JU LEJOHET QË TI MBANI DOKUMENTET TUAJA ME
VETE?**

**A LEJOHENI TA PËRDORNI TELEFONIN APO
GJITHMONË DUHET TË KËRKONI LEJE PËR
PËRDORIMIN E TIJ?**

**A PO SHKON GJITHQKA ASHTU SIQ JENI MARRUR
VESH?**

**A E DINI SE KUSH DO TË JETË PUNËDHËNËSI JUAJ DHE SA
DO TË FITONI?**

**PO PËR KONTRATËN E PUNËS? A KENI TË DREJTË PËR
PUSHIM, PUSHIM PËR SHKAQE SHËNDETSORE? A PUNONI
ME ORAR MAKSIMAL – TETË ORË NË DITË?**


**A E KENI TË DREJTËN E ZGJEDHJES DHE TË DREJTËN TË
THONI 'JO'?**

**A MUND TA NDRYSHONI PLANIN DHE TË LARGOHENI
MENJËHERË?**

“

**SHTROJANI VETES KËTO
PYETJE PARA SE TË
LARGOHENI.**

”



Trafikimi i qenieve njerëzore është i paligjshëm dhe nënkupton trajtimin e njerëzve si objekte. Në Slloveni dhe në Evropë, trafikimi i qenieve njerëzore është një vepër e rëndë penale.

Format e shfrytëzimit: shfrytëzimi i prostitucionit ose forma të tjera të abuzimit seksual, puna e detyruar, skllavëria, robëria, lypja, kriminaliteti i detyruar, martesat ose partneriteti i detyruar, dhe trafikimi i organeve, indeve dhe gjakut.

Trafikantët përdorin dhunë fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale. Përmes mashtrimit dhe manipulimit emocional, ata përfitojnë nga dobësia juaj kur ju keni nevojë për ndihmë, ose ju ofrojnë pagesa dhe përfitime nëse ju e pranoni shfrytëzimin.



**NËSE E GJETNI VETEN TUAJ NË KËTË SITUATË, MOS E
FAJSONI VETEN!**

**MASAT E
VETËMBR
OJTJES**



MASAT E VETËMBROJTJES

UDHËTIMI: Tregojini të paktën një personi tjetër kur, ku dhe me kë po udhëtoni. Mbani telefonin mobil me vete dhe mos harroni tiruani numrat më të rëndësishëm të telefonit: ambasadën e vendit tuaj, policinë dhe organizatat që ofrojnë ndihmë. Do të bënit mirë sikur ti mbanit mend këta numra. Mos ia jepni askujt dokumentin e udhëtimit (pasaportën tuaj). Përveç kësaj, bëni disa fotokopje të dokumenteve të rëndësishme dhe mbajini ato nëpër veshje të ndryshme ose ruani në mënyrë digjitale në "cloud" ose në e-mail.

PUNËSIMI JASHTË VENDIT: Jeni të kujdesshëm në lidhje me burimin e informacionit në lidhje me punësimin e mundshëm jashtë vendit. Gjeni detaje rreth punëdhënësit dhe kontrolloni informacionet për saktësinë e tyre në internet. Para se të filloni çfardo lloj pune, arrini marrëveshje për kushtet e punës dhe kërkoni kontratë, e cila duhet të kontrollohet nga një ekspert – madje për këtë mund të telefononi edhe Shoqërinë Ključ.



MEDAT SOCIALE: Mos harroni se mediat sociale lejojnë komunikimin anonim dhe se disa njerëz që mund ti hasni në mediat sociale nuk e thonë të vërtetën. Nëse caktoni ndonjë takim me dikend që e njihni virtualisht jini shume te kujdesshëm.


RËNJA NË DASHURI: Në Slloveni dhe në mbarë botën, disa burra pjese e rrjeteve kriminale luajnë role kryesore në rrjetet e trafikimit duke u paraqitur si djem të dashuruar që joshin gratë dhe vajzat, të cilat ua dorëzojnë më vonë trafikantëve të qenieve njerëzore. Nëse një burrë ka shumë para dhe shoqëri te gjerë jashtë vendit, por nuk ka punë të rregullt, mendoni më shumë për këtë. Këta burra duken të sjellshëm; ata mund t'i blejnë dhurata një gruaje, ta marrin atë në udhëtime ose pazar jashtë vendit, në mënyrë që ajo të lidhet me ta emocionalisht dhe të ju besojë plotësisht atyre. Kjo është mundësia perfekte që ata ta çojnë gruan diku dhe ta shesin.



Gjithashtu, keni kujdes para se të hyni në marrëdhënie romantike. Ndonjëherë, në këmbim të sigurisë, kulmit mbi kokë dhe të mirave të tjera të nevojshme për mbijetesë, njerëzit kërkojnë që të hyni në marrëdhënie romantike me ta, ku ekuilibri i fuqive nuk është i barabartë. Shumë herë një martesë e tillë mund të përfundojë me keqpërdorim, dhunë fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike. Kini kujdes me kë hyni në një marrëdhënie intime/romantike, gjeni kohë për ta njohur mirë personin dhe mos merrni vendime të nxituara për shkak të situatës në të cilën ndodheni - në vend të kësaj zgjedhjeje kontaktoni një nga organizatat të cilat u ofrojnë ndihmë refugjatëve në vendin në të cilën ndodheni për momentin.

A KENI NEVOJË PËR NDIHMË?

Shoqëria Ključ është e vetmja OJQ në Slloveni e specializuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ne ofrojmë ndihmë konkrete falas për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, si për të huajt që janë subjekt i abuzimit seksual apo çdo forme tjetër e abuzimit në Slloveni, poashtu edhe për shtetasit Sllovenë të cilët bien viktima brenda apo jashtë vendit.




Mënyrat e ndihmës:

- këshillim përmes telefonit,
- këshillim personal,
- asistencë psiko-sociale,
- asistencë ligjore bazike, avokat,
- informata,
- ndihmë për t'i shpëtuar një situatë kërcënuese,
- ndihmë për të kontaktuar autoritetet e zbatimit të ligjit,
- ndihmë për marrjen e lejeve për qëndrim në Republikën e Sllovenisë,
- transferim në shtëpi të sigurt,
- përfshirja në programin e (ri)integrit, dhe
- ndihmë për rikthimin në vendin e origjinës.

Nëse jeni duke u shfrytëzuar në një vend tjetër të Bashkimit Evropian, mund të kontaktoni Kryqin e Kuq, i cili vepron në shumicën e vendeve të BE-së, organizata të tjera humanitare ose të informoni policinë.

Pamfleti u zhvillua me ndihmën e UNHCR-së. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e Shoqërisë Ključ dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e UNHCR-së.

 www.drustvo-kljuc.si

 info@drustvo-kljuc.si

 Društvo Ključ

 drustvokljuc

 **+386 80 17 22**

(ditëve të punës nga ora 9:00 deri në 13:00)